



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**  
**KOMISIONERI**

Nr. 1004/1 Prot.

Tiranë, më 28.05.2026

**V E N D I M**

**Nr. 130, Datë 28.05.2026**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 266, datë 18.11.2025, e paraqitur nga znj. I.K kundër Shkollës së Mesme të Përgjithshme “Jani Nushi”, Lushnje, në të cilën pretendon diskriminimin e fëmijës së saj të mitur: I.K, për shkak të “aftësisë së kufizuar<sup>1</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues ka ngritur pretendime në lidhje me: “1. Vajza ime I.K, ndjek klasën e 10-të në Gjimnazin “Jani Nushi”, Lushnje.

*Drejtoria e shkollës e ka mirëpritur fillimisht vajzën dhe ka treguar bashkëpunim, por dokumentacioni i vajzës nuk është marrë në konsideratë, pasi drejtoria ka preferuar të caktojë një mësuese ndihmëse për dy nxënës, pavarësisht nga shkalla e vështirësisë së diagnostikuar nga KMCAP. Nga ana ime është kërkuar me mirësi që fëmijët të ndahen në dy klasa, për shkak të nevojave të tyre të ndryshme, por dokumentet janë përgatitur për një mësuese të vetme.*

*Pas kërkesave të mia, drejtoria u justifikua se ndarja sipas kërkesës time do të ishte shkelje ligjore. Fillimisht u caktua një mësuese për të mbajtur dy nxënës, ku nxënësi tjetër kishte vendim të komisionit psiko-social për klasë burimore.*

*Pas shumë diskutimesh, komisioni i ZVAP u ringrit dhe u caktuan dy mësuese.*

<sup>1</sup> Referuar Vërtetimit për aftësinë e kufizuar datë 10.03.2025, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror, fëmija I.K, ka diagnozën: Çrregullim i spektrit autik.

*Megjithatë, mësuesja aktuale:*

- *Nuk ka kualifikimin e duhur profesional për fëmijë me AK.*
- *Nuk më informon për ecurinë dhe gjendjen e vajzës sime.*
- *Refuzon bashkëpunimin si me mua, ashtu edhe me punonjësit e tjerë sociale.*
- *I drejtohet vajzës me shprehje denigruese si: “kjo”, “këtë”, “ka kriza”, duke e stigmatizuar.*
- *E nxjerr vajzën nga klasa për gjëra të parëndësishme dhe e mban në klasë burimore të veçuar, në kundërshtim me vendimin e komisionit psiko-social të ZVAP.*
- *Madje disa herë e ka lënë vetëm në të njëjtën klasë me nxënësin tjetër me AK dhe mësuesen e tij.*
- *Në një rast, vajza është parë nga familjarë, e ulur jashtë në oborr pranë nxënësit tjetër. Kjo ngre shqetësim të madh për sigurinë e saj fizike dhe emocionale.*

*2. Ngjarja e datës 28.10.2025.*

*Me miratimin e drejtoreshës, u mbajt një mbledhje me shumë mësues e dy prindër të bordit, por pa praninë e psikologes dhe përfaqësuesve të ZVAP. Mbledhja kishte karakter presioni ndaj meje për ta larguar vajzën nga klasa dhe për ta dërguar kundër vendimit zyrtar në klasë burimore. Më janë atribuar fjalë të pavërteta, me qëllim manipulimin e procesit. Për këtë arsye nuk kam firmosur procesverbalin.*

*3. Veprimet e ZVAP Lushnje.*

*Pas ankesës sime, ZVAP Lushnje kreu verifikime dhe konstatoi se mbledhja e organizuar në shkollë ishte në shkelje të procedurave. Megjithatë problemet vazhdojnë, sepse drejtorja nuk jep dokumentet që më takojnë sipas ligjit (PEI, orare, plane pune), ndalon punonjësen sociale të hyjë në klasë dhe nuk merr masa për të rregulluar marrëdhëniet sociale të vajzës me bashkëmoshatarët”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe zëvendësimin e mësueses ndihmëse znj. P.A.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

- Me shkresën nr. 1616/1, datë 02.17.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga subjektet, lidhur me pretendimet e ankueses.

Me shkresën nr. 198/25, datë 05.12.2025, Shkolla “Jani Nushi”, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Në vijim të pretendimit të paraqitur nga prindi për zhvillimin e një mbledhjeje me datë 28.10.2025, sqaroj se kjo mbledhje nuk është thirrur dhe as udhëhequr nga ana ime, si dhe nuk kam qenë e pranishme në atë takim. Për pasojë, nuk është mbajtur procesverbal, pasi dokumentacioni zyrtar mbahet vetëm për mbledhjet e thirrura dhe të administruara sipas procedurave nga ana ime.*

*Nga informacionet e mbledhura rezulton se prindërit janë mbledhur në mënyrë të pavarur, me iniciativën e tyre, në ambientet e shkollës, me qëllim diskutimin e çështjeve që lidhen me ecurinë mësimore, sjelljen dhe përshtatjen e fëmijëve të tyre. Theksoj se nuk është zhvilluar asnjë mbledhje me karakter diskriminues ndaj ndonjë nxënësi, përfshirë edhe nxënësen me aftësi ndryshe.*

*Prania e prindit të nxënëses në këtë mbledhje ka qenë në funksion të interesave të fëmijës së saj, njësoj si pjesëmarrja e prindërve të tjerë. Megjithatë, duke qenë se mbledhja nuk ka qenë e thirrur zyrtarisht, nuk ekziston procesverbal dhe nuk janë mbajtur të dhëna të tjera shoqëruese, siç do të ishte vepruar në rast të një mbledhjeje të organizuar sipas protokolleve të institucionit.*

*Kjo mbledhje, për shkak të mënyrës së organizimit dhe mungesës së dokumentacionit, është konsideruar mbledhje joformale/jashtë procedurave të rregullta, dhe për këtë arsye, pas monitorimit të kryer në shkollën tonë, janë marrë edhe rekomandimet përkatëse nga ZVAP”.*

Me shkresën nr. 2592/2, datë 11.12.2025, ZVAP Lushnje, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Komisioni Multidisiplinar për vlerësimin e nxënësve me aftësi ndryshe kreu vlerësimin për nxënësit të cilët u regjistruan në fillim viti shkollor. Komisioni sipas Udhëzimit nr. 26, datë 25.11.2019, bëri vlerësimin e nevojave të nxënësve dhe drejtoria e shkollës paraqiti pranë ZVAP Lushnje kërkesën për dy mësues ndihmës.*

*Pas kryerjes së procedurave të punësimit nëpërmjet Portalit “Mësues për Shqipërinë 2025-2026” në zbatim të renditjes, u punësua mësuesja dhe iu caktua nxënëses I.K, bashkëlidhur praktika e punësimit të punonjësës P. A.*

*Drejtoria e shkollës në bashkëpunim me punonjësën e shërbimit psiko-social, mësuesën ndihmëse dhe mësuesit kujdestar, kanë hartuar planin edukativ individual sipas akteve ligjore dhe*

nënligjore në fuqi. Nxënësja është trajtuar nga mësuesja ndihmëse dhe stafi mësimor me përkrahje maksimale duke kërkuar të arrihej socializimi i saj me nxënësit e tjerë të klasës dhe realizimi i objektivave të parashikuara në planin PEI.

Mësuesja ndihmëse me vullnetin e lirë ka paraqitur dorëheqjen nga vendi i punës me datë 25.11.2025 dhe institucioni arsimor ka kërkuar mësuese tjetër për nxënësen I.K.

ZVAP Lushnje pasi trajtoi një ankesë të paraqitur nga punonjësja e kësaj shkolle u informua verbalisht për mbledhjen e datës 28.10.2025 dhe la rekomandim për titullarin e institucionit që asnjë organ kolegjal mos të mblidhet pa zbatuar rrugën administrative. Nga drejtoria e shkollës është pohuar se mbledhja nuk ka qenë e organizuar nga drejtoria e shkollës, por nga vetë prindërit e klasës përkatëse për të diskutuar ecurinë e nxënësve në mësim. Për këtë arsye në dokumentacionin e institucionit arsimor nuk është regjistruar një procesverbal për këtë mbledhje”.

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, ankuesja nëpërmjet e-mail-it datë 17.12.2025, është njohur me përgjigjen e Shkollës “Jani Nushi” dhe ZVAP Lushnje.

Në kundërshtim të përgjigjes të Shkollës “Jani Nushi”, ankuesja me email-in datë 18.12.2026, në mes të tjerash informoi se: “Nuk ka asnjë të vërtetë dhe çdo gjë është lehtësisht e verifikueshme.

1. Nëse mbledhja është thirrur nga mësuesja kujdestare dhe kishte të bënte me ecurinë në mësim të fëmijëve, ku ishin prindërit e tjerë?

Pse ishte vetëm kryetari i bordit dhe një prind tjetër, të cilit i kërkohej të prezantohej, e të tregonte se prindi i cilit fëmijë ishte, me është përgjigjur “s’është puna jote, s’ka rëndësi cilin fëmijë kam”.

Nëse mbledhja ishte me karakter të tillë, pse ZVAP, pranoi ankesën time? Pse ZVAP, në kthimin e përgjigjes e ka cilësuar që prindi (unë) ka të drejtë? Pse në atë mbledhje morën pjesë 7 mësues të tjerë? Nëse situata nuk ishte siç unë kam pretenduar, pse punonjësja sociale e shkollës ka bërë ankesë nga ana e saj për drejtorinë?

Situata jo vetëm ka qenë e tillë, po ditën që grupi i punës, i kryesuar nga vetë drejtoresha Arta Dhamo, në sallë ka qenë përsëri i pranishëm kryetari i bordit L.Z, të cilin drejtoresha A.Dh, pasi e pyeti për çfarë arsye ishte aty, e falënderoi dhe i kërkoi të largohej.

2. Edhe pas kthimit të përgjigjes nga ZVAP, drejtoria e shkollës vazhdoi të mos merrte parasysh nevojat e fëmijës tim, por në mbrojtje të mësueses P.A. Në datë 07.11.2025, ka thirrur një mbledhje të protokolluar me të gjithë mësuesit e shkollës, të cilëve ju ka kërkuar vlerësim me shkrim, mbi punën e mësueses ndihmëse.

Me ç’ të drejtë vendosin mësuesit e tjerë për këtë gjë? Kur prindi nuk është dakord dhe fëmija shihej qartë që nuk ishte mirë me atë mësuese.

3. Në rekomandimet që grupi i punës la, mësuesja ndihmëse e ka pas të detyrueshme të më jepte një herë në javë informacion. Në datë 14.11.2025, jo vetëm që nuk dilte të më shpjegonte se çfarë ka ndodhur me vajzën për një javë, por nuk jam lejuar nga drejtoresha që të futem në ambientet e shkollës, për tu njohur me informacionin javor. Është telefonuar drejtoresha nga roja e shkollës, për të marrë leje që unë të futem dhe përgjigja ka qenë negative. Me çfarë të drejte më mohohet kjo gjë?

4. Edhe sot, në datë 18.12.2025, asnjë nga dokumentet e përmendura, nuk më është dhënë nga drejtorja e shkollës.

5. Ju vë në dijeni se, mësuesja ndihmëse P.A, është larguar dhe zëvendësuar me një mësuese tjetër, por kjo nuk do të thotë se unë heq dorë. Në mënyrë absolute jo, sepse për shkak të këtyre manovrave nga drejtorja e shkollës, stresi emocional i fëmijës tim ishte i pallogaritshëm, aq sa pas 3 vjetësh shkëputje, ne jemi kthyer përsëri në seanca psikologjike me vajzën.

E dyta, manipulimi që bënë me fëmijët e klasës, prishi raportet e vajzës me ta. Të gjithë e donin dhe afronin në fillim, ndërsa tani jo.

E treta, janë të drejta që fëmijës tim dhe çdo fëmije tjetër si ajo, ju takojnë, të rregulluara e të vendosura me ligj, gjë që nuk mund të tjetërsohen, ose interpretohen sipas dëshirës apo humorit të një drejtuesi”.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 296, datë 05.02.2026 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 17.02.2026, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 17.02.2026, pranë Zyrës së Komisionerit, me praninë e ankueses znj. I.K, dhe me praninë e përfaqësueses me autorizimin nr. 368/1, datë 12.02.2026, të ZVAP Lushnje, znj. R.K dhe të drejtores së shkollës “Jani Nushi”, znj. N.S.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, u njoftuan palët se seanca dëgjimore do të regjistrohej dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ankues i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor, si dhe në mes të tjerash deklaroi se: “Në momentet e fillimit pas regjistrimit të vajzës nuk kam pasur probleme me drejtuesen e shkollës, pasi më priti mirë dhe u tregua dashamirëse. Komisioni multidisiplinar i ZVAP në bazë të diagnozës së vajzës ka vendosur që vajza të mbështetet me mësuese ndihmëse për 4 orë në ditë. Drejtorja e shkollës nuk pranoi sepse i erdhi dhe një fëmijë tjetër me aftësi të kufizuara dhe i vendosi të dy në një klasë dhe mësuesja ndihmëse duhet të rrinte me të dy fëmijët. Fëmijët ishin me diagnoza të ndryshme, pasi fëmija tjetër është më i agravuar se fëmija im dhe ka nevojë gjithë kohën për monitorim, sepse godet veten, etj, dmth diagnozë komplet ndryshe. Fillimisht ka qenë një mësuese J.N, për të dy fëmijët. Kjo mësuese ishte mësuese shumë e mirë e cila punonte shumë mirë me vajzën. Në këtë periudhë mësuesja ka punuar me vajzën time dhe me nxënësit tjetër me aftësi të kufizuar, dhe më vonë prindi i nxënësit

*tjetër nuk ka pranuar ta sjellë në shkollë. Drejtoresha nuk ka bërë kërkesë për mësues ndihmës dhe për nxënësin tjetër, që të dy fëmijët të kishin secili mësuesin e tij. Më vonë drejtoresha ka bërë kërkesë dhe për një mësues tjetër dhe në fillim të nëntorit erdhi dhe një mësuese tjetër. Për mësuesen P.A jam ankuar te drejtoresha se mësuesja nuk ishte e duhura. Shkolla nuk më ka njohur me planin PEI, njoftim për ecurinë javore të vajzës, etj. Me mësuesen e re kam bashkëpunim të mirë dhe kam firmosur planin PEI. ”.*

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesja e ZVAP Lushnjë, i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohur gjatë komunikimit shkresor, si dhe në mes të tjerash deklaroi se: *“ZVAP është njohur për rastin e planit PEI pas ankesës së bërë me email, nga punonjësja e shërbimit psiko-social të shkollës në datë 06.11.2025, e cila kishte një problematikë me drejtoren e shkollës. Për këtë çështje është ngritur një grup pune. Në përfundim grupi i punës ka lënë rekomandimin për shërbimin psiko-social të shkollës, për përgatitjen e planit vjetor për nxënësit me AK dhe kompletimin e dosjes personale të nxënësve me AK.*

*Lidhur me emërimin e mësuesve, ZVAP i referohet portalit mësues për Shqipërinë. Mësues të profilit arsim special, janë shumë pak kandidatë të papozicionuar në një vend pune dhe është dëshira e tyre për të pranuar një vend pune ose jo. Në momentin kur nuk ka kandidatë të profilit arsim special, atëherë procedohet me mësues të profileve të tjera. Në shkollën Jani Nushi asnjë mësues i arsimit special nuk ka pranuar të punësohet dhe jemi detyruar të punësojmë mësues të profileve të ndryshme. Fillimisht është punësuar mësuesja J.N, por ajo u largua në një pozicion tjetër dhe pastaj u rihodh dhe njëherë pozicioni dhe pas procedurave, u punësua mësuesja P.A. Pastaj dhe kjo mësuese u largua dhe ZVAP përsëri ndoqi procedurën për përzgjedhjen e një mësueseje tjetër.*

*Znj. I.K është paraqitur disa herë në ZVAP, për problematika të ndryshme. Fillimisht për pjesën e mësueses ndihmëse dhe pastaj ka thënë që drejtoresha e shkollës nuk e lejon të hyjë në shkollë. Duke qenë se kërkesa ishte verbale, titullari i ZVAP ka komunikuar në telefon me drejtoren e shkollës dhe i ka thënë se prindi ka të drejtë të marrë çdo informacion nga shkolla”.*

Gjatë seancës dëgjimore, drejtoresha e shkollës “Jani Nushi” Lushnje, i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor, si dhe në mes të tjerash deklaroi se: *“Lidhur me mbledhjen e datës 28.10.2025, nuk kam marrë pjesë dhe nuk kam dhënë leje për tu zhvilluar mbledhje. Takimi ishte thirrur nga mësuesja kujdestare, por unë nuk isha informuar. Të nesërmen jam informuar dhe kam pyetur mësuesen kujdestare për ngjarjen, dhe i kam dhënë vërejtje verbale mësueses.*

*Në fillim të vitit shkollor datë 08.09.2025, dhe deri kur është emëruar mësuesja ndihmëse, së bashku me punonjësën sociale dhe me stafin pedagogjik, kemi marrë përsipër që vajzën ta mbanim vetë. Kam bërë kërkesë për një mësues ndihmës që i është vendosur në dispozicion vajzës. Derisa ka ardhur mësuesi ndihmës tjetër për nxënësin tjetër, prindi nuk ka pranuar ta sillte fëmijën në shkollë.*

Ankuesja nuk ka pranuar të firmosë planin PEI, për arsye të mosmarrëveshjeve mes saj dhe mësueses ndihmëse P.A. Prindi ka pretenduar se mësuesja nuk është e aftë, nuk ka komunikim dhe nuk bën për vajzën e saj. Plani PEI është bërë dy javë pasi ka filluar shkolla.

Me mësuesen tjetër prindi ka bashkëpunim dhe ka firmosur planin PEI. Unë e kam lejuar ankuesen sa herë ka dashur, për të hyrë në shkollë dhe nuk ka pasur pengesa”.

- Në vijim, ZVAP Lushnje me shkresën nr. 462, datë 02.03.2026, dërgoi dokumentacionin e kërkuar gjatë seancës dëgjimore.

### III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes

Arsimi parauniversitar në Republikën e Shqipërisë rregullohet nga ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili në nenin 1 përcakton objektin, qëllimin dhe fushën e zbatimit të tij, ndërsa në nenin 4 sanksionon se sistemi arsimor parauniversitar funksionon në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin shqiptar në fuqi dhe vlerat e sistemeve arsimore bashkëkohore.

Neni 5, pika 1 i ligjit nr. 69/2012 parashikon se: “1. Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar...”.

Neni 54, i ligjit nr. 69/2012, “Drejtori i Institucionit Arsimor” përcakton se:

“1. Drejtori drejton veprimtarinë e institucionit arsimor. 2. Drejtori i institucionit arsimor, publik ose privat, është përgjegjës për: a) zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij; b) përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor; c) zbatimin dhe zhvillimin e kurrikulës; ç) menaxhimin e personelit dhe krijimin e kushteve për zhvillimin profesional të punonjësve të institucionit. 3. Drejtori i institucionit arsimor publik kryen edhe këto detyra: a) menaxhon institucionin, përfshirë edhe menaxhimin financiar;”. Kjo dispozitë e ngarkon drejtuesin e shkollës me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për zbatimin korrekt të detyrimeve që burojnë nga legjislacioni për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Referuar Kreut X, neni 42, të Rregullores “Për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, miratuar nga MAS me Urdhërin Nr. 31, datë 28.01.2020, të ndryshuar, është parashikuar se: “1. Drejtori i IA-së është titullari i institucionit, që ka drejtën e firmës dhe të vulës së institucionit. .... 3. Drejtori ka përgjegjësi zbatimin në IA të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi..... 8. Drejtori merr masa për të siguruar ndjekjen e shkollës nga nxënësit e arsimit bazë, që i përkasin zonës së shkollës. Drejtori i IA-së publike të arsimit bazë me kohë të plotë bashkëpunon me NjMF-në, këshillin e prindërve të shkollës dhe këshillat e prindërve të klasave,

qeverinë e nxënësve, me shërbimin psiko-social dhe me bordin e shkollës për të siguruar ndjekjen e shkollës nga nxënësit”.

Referuar dosjes së administruar, subjekti ankues ka pretenduar, se edhe pse vajza e saj ishte regjistruar në Gjimnazin “Jani Nushi” dhe ishte pajisur me dokumentacionin përkatës, shkolla fillimisht ka synuar ta trajtojë situatën e saj në mënyrë të njëjtë me një nxënës tjetër me nevoja të ndryshme arsimore, duke parashikuar një mësuese ndihmëse për dy nxënës dhe mësuesja ndihmëse P.A, e caktuar nuk ka bashkëpunuar siç duhet me prindin, nuk ka ofruar informacion të rregullt mbi ecurinë e nxënësës. Ankuesja ka pretenduar gjithashtu se në shkollë është zhvilluar një mbledhje me karakter presioni ndaj saj, me qëllim orientimin e nxënësës drejt klasës burimore, si dhe se shkolla nuk i ka vënë në dispozicion dokumentacionin që lidhej me PEI-n, oraret dhe planet përkatëse.

**A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm të nxënësës I.K, e përfaqësuar nga prindi znj. I.K, nga ana e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Jani Nushi”, Lushnje**

Shkolla Jani Nushi me shkresën nr. 039/25, datë 08.09.2025, drejtuar ZVAP Lushnje ka kërkuar vlerësimin e nxënësve me AK, I.K dhe A.Z.

Komisioni Multidisiplinar pranë ZVAP Lushnje, me shkresën nr. 1584/4, datë 16.09.2025 ka bërë vlerësimin e nxënësës I.K dhe ka arritur në konkluzionin se nxënësja me diagnozë “epilepsi e gjeneralizuar, çrregullime të spektrit të autizmit, ADHD”, ka nevojë për mësues ndihmës, për 4 orë mbështetje ditore. Në rekomandimin e po kësaj date, drejtuar shkollës “Jani Nushi”, Komisioni ka rekomanduar shprehimisht që nxënësja të ndjekë arsim të zakonshëm, me Plan Edukativ Individual, me kurrikul të përshtatur, të asistohet nga mësues ndihmës 20 orë gjatë javës, të qëndrojë e shoqëruar me mësuesin mbështetës në klasë me nxënësit e tjerë, si edhe të asistohet nga prindi/familjari për kryerjen e nevojave personale. Në të njëjtin rekomandim është shënuar qartë se nxënësja nuk paraqet nevojën për përdorimin e klasës burimore dhe se shërbimi psiko-social i shkollës duhet të monitorojë punën e mësuesit ndihmës dhe t’i ofrojë asaj mbështetje sipas situatave. Këto rekomandime janë thelbësore, pasi përcaktojnë standardin konkret të mbështetjes që duhej garantuar në shkollë për nxënësen.

Ndërkohë Komisioni Multidisiplinar i ZVAP Lushnjë, në rekomandimin datë 16.09.2025, për nxënësin A.Z, nxënës i klasës së X-të, në shkollën “Jani Nushi”, ka rekomanduar që nxënësi të qëndrojë i shoqëruar me mësuesin ndihmës në klasë të veçuar, pa praninë e nxënësve të tjerë apo pjesën tjetër të klasës dhe i rekomandon shkollës që nxënësi të ndjekë mësimin e alternuar midis shtëpisë dhe një klase të veçantë në shkollë, duke u mbështetur nga mësuesi ndihmës. Shkolla Jani Nushi me vërtetimin nr. 238/26, datë 18.02.2026, ka informuar se nxënësi A.Z nuk është paraqitur në shkollë nga data 08.09.2025 deri më datë 21.10.2025.

Referuar procesverbalit nr. 1922, datë 29.09.2025, të ZVAP Lushnje, rezulton se mësuesja J.N ka pranuar pozicionin e punës si mësuese ndihmëse në shkollën Jani Nushi, dhe në datë 30.09.2025 është lidhur kontrata e punës mes shkollës dhe mësueses.

Rezultoni se mësuesja ndihmëse J.N, ka hartuar PEI për nxënësen I.K, për vitin shkollor 2025-2026, por ky plan nuk ka datë dhe nuk është i firmosur nga prindi, me arsyetimin e shkollës se nuk ishte i plotë.

Me shkresën nr. 131/25, datë 08.10.2025, shkolla ka kërkuar nga ZVAP Lushnje, një mësues të profilit arsim special, për arsye sepse në shkollë është një nxënës me nevoja të veçanta.

Shkolla Jani Nushi, me Vendimin nr. 41, datë 14.10.2025, ka vendosur ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me mësuesen J.N, për arsye se mësuesja mori një pozicioni tjetër pune.

ZVAP Lushnje me shkresën nr. 2140/1, datë 13.10.2025, ka njoftuar shkollën Jani Nushi, se mësuese P.N është kandidati që ka zgjedhur shkollën për tu punësuar si mësuese ndihmëse, për nxënësen I.K.

ZVAP Lushnje me shkresën nr. 2269/1, datë 20.10.2025, ka njoftuar shkollën Jani Nushi, se mësuese B.N është kandidati që ka zgjedhur shkollën për tu punësuar si mësuese ndihmëse, për nxënësin A.Z. Në datë 21.10.2025, është lidhur kontrata e punës mes shkollës Jani Nushi dhe mësueses B.N.

Shkolla Jani Nushi me vendimin nr. 42, datë 25.11.2025, ka vendosur ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me mësuesen ndihmëse P.N, për arsye se mësuesja mori një pozicion tjetër pune.

Referuar Relacioneve mujore për zhvillimin e procesit mësimor lidhur me aktivitetet që kryen nxënësi me aftësi ndryshe, rezultoni se këto relacione për nxënësen I.K, për muajin tetor 2025, janë plotësuar nga mësuesja ndihmëse P.A, për muajin nëntor 2025 është plotësuar nga punonjësja e shërbimit psiko-social A.V, dhe për muajin dhjetor 2025 është plotësuar nga mësuesja ndihmëse K.K.

Rezultoni se në datë 28.10.2025, Komisioni i shkollës për aftësinë e kufizuar ka hartuar planin PEI për nxënësen I.K, por me shënimin se prindi nuk ka pranuar të bashkëpunojë.

Rezultoni se subjekti ankues me shkresën datë 30.10.2025, dhe email-in datë 14.11.2025, i është drejtuar shkollës Jani Nushi, në të cilën ka kërkuar largimin e mësueses ndihmëse P.N, për arsye se mësuesja nuk ka përgatitjen e duhur akademike për të punuar me programet e përshtatura dhe nuk zbaton rekomandimet e dhëna në vendim nga komisioni psiko-social i ZVAP-së. Gjithashtu, ankuesja me email-in datë 17.11.2025, ka vënë në dijeni ZVAP Lushnje se drejtoresha e shkollës ka urdhëruar që të mos futet në mjediset e shkollës, për të marrë informacion mbi ecurinë javore të vajzës dhe se mësuesja ndihmëse P.A nuk ka pasur sjellje korrekte ndaj vajzës, gjë e cila ka çuar në shqetësime emocionale të saj.

Nga dokumentacioni i shqyrtuar, Komisioneri vëren se në rastin konkret ka pasur një mospërputhje të dukshme ndërmjet standardit të mbështetjes së rekomanduar nga Komisioni Multidisiplinar dhe problematikave të raportuara nga ankuesja në zbatimin konkret të këtij standardi në shkollë.

Ankuesja ka pretenduar jo thjesht pakënaqësi subjektive, por elemente që prekin thelbin e arsimit gjithëpërfshirës: mosrespektimin e rekomandimit për zhvillimin e procesit mësimor në klasë me nxënësit e tjerë; përdorimin në praktikë, të një forme veçimi që bie ndesh me rekomandimin “nuk paraqet nevojën për përdorimin e klasës burimore”; mungesën e komunikimit periodik me prindin; mosvënien në dispozicion të dokumentacionit; si dhe dështimin për të siguruar një mjedis emocionalisht të sigurt dhe pa stigmatizim. Këto pretendime nuk mund të konsiderohen dytësore, sepse lidhen drejtpërdrejt me cilësinë e përfshirjes së nxënësës në procesin arsimor dhe me dinjitetin e saj në mjedisin shkollor.

Rezulton se nga fillimi i vitit shkollor në datë 08.09.2025 dhe deri në datë 21.10.2025, në shkollë kanë qenë dy nxënës me aftësi të kufizuara, me vlerësim nga Komisioni multidisiplinar për mbështetje me mësues ndihmës me nga 20 orë në javë, ndërsa në shkollë ka pasur një mësues ndihmës nga data 30.09.2025 deri në datë 20.10.2025. Nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se shkolla megjithëse ka pasur dijëni që në fillim të vitit shkollor, se do të ishin dy nxënës me aftësi të kufizuara që ishin rekomanduar për tu mbështetur me mësues ndihmës me nga 20 orë në javë, nuk ka bërë kërkesë për dy mësues ndihmës që në fillim të vitit shkollor.

Gjithashtu, rezulton se deri në periudhën kur është larguar mësuesja ndihmëse P.A (datë 25.11.2025) nxënësja nuk ka pasur një plan PEI të hartuar në bashkëpunim me prindin.

Në lidhje me sa më sipër, Komisioneri vlerëson se detyrimet e institucionit arsimor dhe të drejtorit të tij, në raport me nxënësen I.K., nuk burojnë vetëm nga nevoja e përgjithshme për administrimin e procesit mësimor, por nga një regjim i posaçëm ligjor e nënligjor, i cili kërkon trajtim të shtuar mbrojtës, përfshirës dhe të individualizuar për nxënësit me aftësi të kufizuara. Ky standard i shtuar del qartë nga ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, nga Rregullorja e miratuar me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, e ndryshuar, dhe nga Udhëzimi nr. 26, datë 25.11.2019.

Së pari, referuar nenit 5, pika 1 të ligjit nr. 69/2012, e drejta për arsimim garantohet pa diskriminim, ndër të tjera edhe për shkak të aftësisë së kufizuar. Neni 6 i po këtij ligji parashikon në mënyrë të shprehur se: interesi i nxënësit është parësor; në sistemin arsimor respektohen, mbrohen dhe promovohen të drejtat e fëmijëve; nxënësve u ofrohet mbrojtje nga çdo veprim ose mosveprim që mund t’u shkaktojë diskriminim, keqtrajtim ose dëm moral; në institucionet arsimore zbatohet parimi i gjithëpërfshirjes; dhe nxënësve me aftësi të kufizuara u ofrohet përkujdesje e posaçme. Këto parime nuk kanë natyrë deklarative, por përbëjnë standarde konkrete detyruese për sjelljen dhe organizimin e shkollës në çdo rast individual.

Së dyti, neni 32, pika 1 e ligjit nr. 69/2012 ngarkon institucionin arsimor me detyrimin për krijimin e një mjedisi miqësor për nxënësit dhe të mundësive që secili nxënës të shfaqë, të zhvillojë individualitetin dhe të realizojë potencialin e tij. Ndërsa neni 61, pika 1, shkronja “c” e të njëjtit ligj, i njeh nxënësit të drejtën që t’i sigurohet nga institucioni shërbim arsimor cilësor, sipas interesave, nevojave dhe mundësive të tij, si dhe ndihmë e posaçme për të përballuar vështirësitë e veçanta të të nxënësit; po ashtu, shkronja “ç” e po kësaj pike i garanton të drejtën për t’u vënë në

dijeni me shkrim mbi elementët thelbësorë të procesit arsimor. Në të njëjtën frymë, neni 62, pika 1 e ligjit nr. 69/2012, i konsideron prindërit partnerin kryesor të institucionit arsimor në mbarëvajtjen e fëmijës dhe të vetë institucionit. Kjo do të thotë se shkolla kishte jo vetëm detyrimin për të pranuar formalisht nxënësen, por për të garantuar në mënyrë efektive përfshirjen e saj të sigurt, të përshtatur dhe të bashkërenduar me prindin.

Së treti, neni 54, pika 2, shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të ligjit nr. 69/2012 përcakton se drejtori i institucionit arsimor është përgjegjës për zbatimin e ligjit dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, për përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor, për zbatimin dhe zhvillimin e kurrikulës, si edhe për menaxhimin e personelit dhe krijimin e kushteve për zhvillimin profesional të punonjësve. Për pasojë, në rastin konkret, përgjegjësia e shkollës nuk mund të reduktohet vetëm te veprimet individuale të mësueses ndihmëse, por shtrihet mbi drejtimin dhe administrimin institucional të gjithë procesit: ngritjen dhe funksionimin e komisionit të IA-së, bashkëpunimin me prindin, respektimin e rekomandimeve të Komisionit multidisiplinar, mbikëqyrjen e mësuesit ndihmës, ruajtjen e dinjitetit të nxënëses dhe krijimin e një mjedisi realisht gjithëpërfshirës.

Së katërti, Kreu XI i ligjit nr. 69/2012 vendos detyrime të posaçme për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Neni 63, pika 2, sanksionon se përfshirja dhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme është parësore. Neni 64, pika 3, parashikon krijimin e komisionit multidisiplinar nga njësi arsimore vendore, i cili jep rekomandimet përkatëse për ndjekjen nga fëmija të institucionit arsimor të zakonshëm ose të specializuar. Neni 64, pika 4, parashikon se prindërit vendosin nëse fëmija i tyre me aftësi të kufizuara do të ndjekë një institucion të zakonshëm apo të specializuar. Më tej, neni 65, pika 1, kërkon që nxënësi me aftësi të kufizuara të mësojë sipas planeve e programeve të përshtatura për të; neni 65, pika 2, kërkon që programi i personalizuar të hartohet nga komisioni i institucionit në bashkëpunim me prindërit; ndërsa neni 65, pika 3, kërkon që nxënësit me aftësi të kufizuara t’u sigurohen mësues ndihmës dhe shërbim rehabilitues sipas kriterëve të përcaktuara me udhëzim të ministrit. Këto dispozita i japin shkollës detyrimin e qartë që ta organizojë procesin arsimor jo sipas komoditetit administrativ të saj, por sipas nevojave konkrete të nxënëses dhe në përputhje me rekomandimin zyrtar.

Së pesti, Udhëzimi nr. 26, datë 25.11.2019 *“Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”* përcakton se mësuesi ndihmës, si rregull, duhet të jetë i profilit “arsim special”, ndërsa procedurat e përzgjedhjes së tij duhen ndjekur sipas kuadrit përkatës ligjor dhe nënligjor. Pra, në rastin konkret, shkolla kishte detyrimin të garantonte jo thjesht caktimin formal të një mësuesi ndihmës, por sigurimin e një figure profesionale të përshtatshme dhe funksionalisht të aftë për të përmbushur nevojat e nxënëses. Nëse mësuesi ndihmës nuk kishte profilin e duhur, nuk bashkëpunonte me prindin, nuk ndiqte rekomandimet e vendimit të komisionit ose krijonte praktika stigmatizuese apo përjashtuese, kjo nuk mbetet vetëm problem individual i punonjësit, por pasqyron mosushtrimin efektiv të përgjegjësive mbikëqyrëse nga shkolla dhe drejtori.

Së gjashti, Rregullorja për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare, miratuar me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, e ndryshuar, në Kreun XIV, neni 80, pika 3, parashikon se

komisioni vlerëson nevojat arsimore të fëmijës dhe ecurinë e tij me kërkesën e prindit ose të drejtorit të IA-së; pika 4 parashikon se komisioni mblidhet tri herë në vit; pika 5 ngarkon drejtorin e IA-së që të këshillohet me komisionin e institucionit para se t'i drejtohet komisionit në ZVA dhe të bashkëpunojë me personin që ushtron përgjegjësinë prindërore; ndërsa pika 7, shkronjat “a” dhe “b”, parashikojnë se komisioni njofton prindin për gjendjen dhe ecurinë e fëmijës dhe i jep me shkrim rekomandimin përkatës. Kjo do të thotë se bashkëpunimi me prindin, njoftimi i tij dhe dhënia me shkrim e rekomandimeve nuk janë zgjedhje fakultative të shkollës, por detyrime të drejtpërdrejta procedurale dhe materiale.

Nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se, me rekomandimin e Komisionit Multidisiplinar të ZVAP Lushnje, datë 16.09.2025, për nxënësen I.K është rekomanduar arsim i zakonshëm, Plan Edukativ Individual, kurrikul e përshtatur, asistim nga mësues ndihmës 20 orë gjatë javës, si dhe qëndrim i shoqëruar me mësuesin mbështetës në klasë me nxënësit e tjerë. Në të njëjtin rekomandim është shënuar qartësisht se nxënësja nuk paraqet nevojën për përdorimin e klasës burimore. Po ashtu, është rekomanduar që komisioni i institucionit arsimor të mbështesë mësuesin ndihmës dhe mësuesit lëndorë për hartimin e planeve përkatëse dhe të PEI-së, si edhe që shërbimi psiko-social i shkollës të monitorojë punën e mësuesit ndihmës dhe t'i ofrojë mbështetje sipas situatave. Këto rekomandime krijonin për shkollën një kornizë detyruese zbatimi dhe jo një hapësirë diskrecionale për interpretim sipas komoditetit të saj organizativ.

Në të njëjtën kohë, nga PEI i administruar në dosje rezulton se për nxënësen I.K mësuesja ndihmëse e caktuar ishte P.A dhe se dokumenti është plotësuar në datën 28.10.2025 dhe jo në dakordësi me prindin. Vetë ky fakt tregon se shkolla kishte hyrë në fazën e individualizimit të procesit, çka e bënte edhe më të fortë detyrimin e saj për zbatim korrekt, të kujdesshëm dhe të dokumentuar të rekomandimeve të Komisionit multidisiplinar. Për pasojë, çdo devijim nga ky standard, si veçimi i pajustificuar nga klasa e zakonshme, mospërfshirja reale në orën mësimore, mungesa e komunikimit me prindin, mosdhënia e dokumentacionit apo mosmonitorimi i mësuesit ndihmës nga shërbimi psiko-social, përbën jo thjesht mangësi organizative, por shkelje të detyrimeve funksionale të shkollës.

Komisioneri vlerëson se shkolla mbante këto përgjegjësi konkrete: - të zbatonte rekomandimin e komisionit multidisiplinar sipas përmbajtjes së tij; - të garantonte që nxënësja të mbështetej në klasën e zakonshme me nxënësit e tjerë; - të mos e orientonte atë drejt klasës burimore në kundërshtim me rekomandimin zyrtar; - të siguronte mësues ndihmës të përshtatshëm sipas kriterëve ligjore; - të organizonte dhe funksionalizonte komisionin e IA-së; - të bashkëpunonte realisht me prindin në hartimin dhe zbatimin e PEI-së; - të informonte prindin për gjendjen dhe ecurinë e fëmijës; - të jepte dokumentacionin përkatës me shkrim; - të ngarkonte shërbimin psiko-social me monitorim aktiv; - si dhe të garantonte një mjedis pa stigmatizim, pa përjashtim dhe pa dëm moral për nxënësen. Këto janë detyrime që burojnë drejtpërdrejt nga nenet 5, 6, 32, 54, 61, 63, 64 dhe 65 të ligjit nr. 69/2012, nga neni 80 i Rregullores së miratuar me Urdhrin nr. 31/2020, të ndryshuar, si dhe nga Udhëzimi nr. 26/2019.

Sa i takon shkeljeve të konstatuara, Komisioneri çmon se nga përmbajtja e akteve të dosjes dhe nga pretendimet e mbështetura në dokumentacion del se shkolla nuk ka respektuar në mënyrë të plotë dhe të qëndrueshme standardin ligjor që i ngarkohej. Së pari, të garantonte që nxënësja të mbështetej me mësues ndihmës në klasën e zakonshme, së dyti, të bashkëpunonte realisht me prindin në hartimin dhe zbatimin e planit PEI, së treti, rezulton se komunikimi dhe bashkëpunimi me prindin nuk kanë qenë në nivelin e kërkuar nga neni 65, pika 2 e ligjit nr. 69/2012 dhe neni 80 i Rregullores, për sa kohë vetë ankuesja ka ngritur si shqetësim mungesën e informacionit dhe mosvënien në dispozicion të dokumenteve dhe së katërti, të informonte prindin për ecurinë e fëmijës dhe të jepte dokumentacionin përkatës me shkrim.

Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se, shkolla “Jani Nushi”, përmes mënyrës së organizimit dhe administrimit të procesit mësimor për nxënësen, nuk provoi se ka përmbushur standardin e kujdesit të shtuar që kërkohet ndaj një nxënësi me aftësi të kufizuara dhe për pasojë, veprimet dhe mosveprimet e saj kanë prodhuar për fëmijën një trajtim të padrejtë dhe të pafavorshëm në raport me të drejtën për arsimim gjithëpërfshirës dhe të përshtatur.

## **B. Shkaku i mbrojtur**

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon në mënyrë të drejtpërdrejtë zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar, të pretenduar nga ankuesi si shkak diskriminues, duke parashikuar në nenin 1, të tij se : *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Në ankesën e depozituar ankuesja pretendon diskriminimin e vajzës së saj I.K, për shkak të aftësisë së kufizuar. Referuar Vërtetimit për aftësinë e kufizuar datë 10.03.2025, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror, fëmija është person me aftësi të kufizuara dhe ka diagnozën: Çrregullim i spektrit autik.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson të provuar faktin se nxënësja I.K, përfaqësuar në këtë proces nga znj. I.K, nëna e ankueses, mbart shkaku të pretenduar të diskriminimit, atë të aftësisë së kufizuar.

Sa më sipër, Komisioneri çmon se, shkaku i diskriminimit i pretenduar nga ankuesja aftësia e kufizuar është një shkak që gëzon mbrojtje sipas nenit 1, të LMD dhe se bazuar në provat e administruara rezulton se vajza e ankueses e mbart këtë shkak.

## **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë me shkaku të mbrojtur**

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjisllacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 57 të Kushtetutës sipas të cilit “*Kushdo ka të drejtën për arsimim*”. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: “*Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta*”, si dhe “*Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë*” (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese)

E drejta për arsim, është një e drejtë kushtetuese, e cila duhet të sigurohet mbi baza të barabarta dhe pa diskriminim. E drejta për arsim garantohet edhe në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat vendi ynë i ka ratifikuar duke u bërë kështu pjesë e sistemit të brendshëm ligjor dhe të detyrueshme për t’u zbatuar.

Në nenin 3, pika 1 të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet se: “*Diskriminim*” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”. Ky ligj parashikon disa forma nëpërmjet të cilave mund të shfaqet sjellja diskriminuese, duke përcaktuar në nenin 3, pika 2, se: “*2. “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji*”.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e arsimit gëzon një mbrojtje të veçantë sipas ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar. Në nenin 17/1ç, 17/2 dhe 17/4, të këtij ligji, përcaktohet: “*1. Ndalohet çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ç) trajtimin e studentëve ose nxënësve, duke përfshirë pranimin, vlerësimin, zbatimin e masave disiplinore ose përjashtimin e tyre. 2. Ndalohet t’i refuzohet një personi ose një grupi personash pranimit në një institucion arsimor publik, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji...4. Zbatimi i masave të posaçme dhe të përkohshme, bazuar në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, me qëllim përshpejtimin e barazisë në arsim, nuk konsiderohet diskriminim. Zbatimi i masave të tilla, në asnjë rast, nuk mund të nënkuptojë mbajtjen e përhershme të standardeve të pabarabarta ose të ndryshme dhe këto masa ndërpriten kur arrihet objektivi i trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta... ”.*

Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”<sup>2</sup>(KDPAK), e cila përbën standartin më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, pranon diversitetin e personave me aftësi të kufizuara. Konventa ka *pranuar se*, aftësia e kufizuar, është një koncept evolues dhe se aftësia e kufizuar, rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierave të qëndrimit/mentalitetit dhe ambientit, që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët. Ky përcaktim synon gjithpërfshirjen dhe jo përjashtimin. KDPAK, ka sanksionuar vlerësimin e aftësisë së kufizuar bazuar në modelin bio-psiko-social, një qasje bazuar në të drejtat e njeriut, ndryshe nga modeli mjekësor, mbi bazën e të cilit është vlerësuar aftësia e kufizuar, deri para miratimit të kësaj Konvente. Konventa ka për qëllim të nxisë, të mbrojë dhe t’u sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre.

KDPAK ndalon çdo formë diskriminimi ndaj personave me aftësi të kufizuara. Ky parim ka të bëjë jo vetëm me mosdiskriminimin e personave me aftësi të kufizuar në raport me personat e tjerë, por edhe brenda kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar. Konventa në mënyrë të posaçme në nenin 4/1, ka përcaktuar se: “*Shtetet Palë marrin përsipër të sigurojnë dhe promovojnë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuar pa diskriminim të ndonjë lloji me bazë aftësinë e kufizuar*”.

Në frymën e Konventës, është miratuar, Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, që ka si qëllim, të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes; të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre, të barabartë në shoqëri.

*Persona me aftësi të kufizuara*, sipas këtij ligji, janë, individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët. Në gërmën “b”, të pikës 2, të nenit 5, të Ligjit nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” parashikohet se: “*Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës e, ndër të tjera, të kenë akses përkatësisht: b) në shkollat e zakonshme dhe të studiojnë në shkollën për të cilën të dëshirojnë...*”.

---

<sup>2</sup>Ratifikuar me ligjin nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

Ligji nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili ka si qëllim garantimin e të drejtës kushtetuese për arsimim, sanksionon se, e drejta për arsimim garantohet pa u diskriminuar. Çdo nxënësi duhet t’i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim, pavarësisht nga vendi ku ai banon apo ndjek shkollën.

Lidhur me arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor parauniversitar, legjislacioni shqiptar, në nenin 64/3 të Ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton si detyrim ligjor që institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të krijojë një komision multidisiplinor, të përbërë nga mjekë, psikologë, mësues dhe specialistë për fëmijët me aftësi të kufizuara, i cili, vlerëson fëmijët me aftësi të kufizuara dhe jep rekomandimet përkatëse për ndjekjen nga fëmija të një institucioni arsimor të zakonshëm a të specializuar. Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet e arsimit special për ta është përgjithësisht e përkohshme, përbën një nga parimet e arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, përcaktuar nga neni 63, i ligjit të sipërcituar. Gjithashtu, referuar parashikimit të nenit 65, pika 3, të Ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nxënësve me aftësi të kufizuara u sigurohen dhe mësues ndihmës, sipas kritereve të përcaktuara me udhëzim të ministrit.

Barra e provës në çështjet e diskriminimit rregullohet nga neni 33, pika 7/1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek pala e akuzuar, e cila duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojnë njëherë nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin<sup>3</sup>.

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është shkak i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur

<sup>3</sup>[https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf), fq.232.

pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “*të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave...provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht<sup>4</sup>”.*

Mbështetur në provat e depozituara dhe në vijim të analizës së mësipërme, u provua se nxënësja I.K mbart shkakun e mbrojtur të aftësisë së kufizuar, në kuptim të nenit 1 të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri vlerëson se mbetet për t’u analizuar nëse trajtimi i padrejtë dhe i pafavorshëm i konstatuar ka ndodhur pikërisht për shkak të kësaj aftësie të kufizuar. Për rrjedhojë, për të arritur në konkluzionin e diskriminimit, nuk mjafton vetëm konstatimi i një trajtimi të pafavorshëm, por duhet të provohet se ky trajtim është i lidhur në mënyrë shkakësore me aftësinë e kufizuar të subjektit të mbrojtur.

Nga provat e administruara dhe nga analiza e bërë, rezultoi se shkolla “Jani Nushi”, Lushnje, nuk provoi se kishtë përmbushur në mënyrë të plotë, në kohë dhe sipas procedurës detyrimet e saj të posaçme ligjore, të cilat aktivizohen pikërisht për shkak të statusit të fëmijës si nxënës me aftësi të kufizuara. Konkretisht, mangësitë e konstatuara lidhen me:

- Mosgarantimin e mbështetjes së nxënësës me mësues ndihmës në klasën e zakonshme.
- Mosbashkëpunimin me prindin në hartimin dhe zbatimin e planit PEI.
- Komunikimi dhe bashkëpunimi me prindin nuk kanë qenë në nivelin e kërkuar nga neni 65, pika 2 e ligjit nr. 69/2012 dhe neni 80 i Rregullores.
- Mosinformimin e prindit për ecurinë e fëmijës dhe mosdhënien e dokumentacionit përkatës me shkrim.

Këto nuk janë detyrime të përgjithshme për çdo nxënës në të njëjtën formë e intensitet, por janë detyrime të shtuara, specifike dhe të posaçme, të cilat legjislacioni i arsimit parauniversitar dhe aktet nënligjore i parashikojnë pikërisht në mbrojtje të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Për këtë arsye, moszbatimi i tyre nuk mund të shihet si një parregullsi neutrale, por si një mosveprim që prek drejtpërdrejt ushtrimin e së drejtës për arsimim të këtij nxënësi për shkak të karakteristikës së tij të mbrojtur.

Bazuar në aktet e administruara dhe konstatimet e mësipërme, Komisioneri vlerëson se, në pamje të parë, pra *prima facie*, faktet dhe provat e administruara krijojnë prezumimin se, nxënësja I.K, i është nënshtruar një trajtimi më pak të favorshëm, për shkak se është person me aftësi të kufizuara.

---

<sup>4</sup> GJEDNJ, *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (GC) paragrafi 147, (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, *Timishev kundër Rusisë* (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, *D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

Komisioneri vëren se trajtimi i konstatuar si i padrejtë dhe i pafavorshëm, nuk ka ardhur në një kontekst të zakonshëm administrativ, por në rrethanat kur subjekti i prekur ishte një fëmijë me diagnozë të spektrit autik, për të cilin ligji kërkon masa të posaçme mbështetëse dhe përshtatje të arsyeshme në procesin arsimor. Pikërisht për shkak të kësaj gjendjeje, institucionet kishin detyrimin të vepronin me kujdes të shtuar, me reagim të shpejtë dhe me mbështetje të personalizuar. Mosgarantimi i këtyre masave bëri që nxënësja të vendosej në një pozitë më të pafavorshme se ajo në të cilën do të ishte vendosur një nxënës tjetër pa aftësi të kufizuar, sepse në vend që aftësia e kufizuar të trajtohej përmes mbështetjes së shtuar, ajo u shoqërua me mungesë ndërhyrjeje efektive, me formalizëm procedural dhe me transferim të pasojave negative mbi vetë fëmijën. Në këtë kuptim, trajtimi i pafavorshëm nuk është thjesht një pasojë administrative, por është produkt i dështimit për të zbatuar garancitë shtesë që ligji njeherë pikërisht për nxënësit me aftësi të kufizuara.

Komisioneri vlerëson se shkeljet e konstatuara nuk kanë mbetur në nivelin e pakujdesisë dhe mangësive të thjeshta administrative, por janë materializuar në një trajtim të padrejtë ndaj nxënëses, pasi i kanë kufizuar asaj mundësinë për të përfutur realisht dhe në mënyrë dinjitoze nga arsimit gjithëpërfshirës që i garanton ligji. Po kështu, provohet se ky trajtim i padrejtë lidhet drejtpërdrejt me shkakun e mbrojtur, pasi vetë detyrimet e posaçme të shkollës, vetë rekomandimet e strukturave kompetente dhe vetë problematikat e evidentuara në këtë rast burojnë pikërisht nga statusi i nxënëses si fëmijë me aftësi të kufizuara në arsimin e zakonshëm. Pikërisht kjo lidhje ndërmjet mosveprimit institucional dhe statusit të mbrojtur e bën trajtimin e konstatuar një trajtim diskriminues në kuptim të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025<sup>5</sup>, citon ndër të tjera se:

*“Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar (PKVPAK) 2021-2025, është një dokument ndërsektorial i qeverisë shqiptare që përfshin politika të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara e që do të hidhen për zbatim gjatë 5 vjeçarit të ardhshëm. Qëllimi i tij është të vazhdojë promovimin dhe mbështetjen e integritit të personave me aftësi të kufizuara në jetën social-ekonomike të vendit duke patur në vëmendje të vazhdueshme përmbushjen e detyrimeve të KDPAK përmes masave specifike.*

*Procesi i hartimit të këtij dokumenti përputhet edhe me një moment tjetër të rëndësishëm të zbatimit të politikave për aftësinë e kufizuar në Shqipëri në funksion të realizimit të parimeve të KDPAK, të ratifikuar nga shteti shqiptar.*

*Sigurimi i arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës dhe i të mësuarit gjatë gjithë jetës për personat me aftësi të kufizuara është një ndër qëllimet politike të PKVPAK. Objektivat specifike në kuadër të këtij qëllimi, të parashikuara në këtë plan përcaktojnë: (i) Rritja e mundësive për pjesëmarrje në arsimin gjithëpërfshirës për fëmijët me lloje të ndryshme të AK-së; (ii) Shndërrimi i shkollave të specializuara në qendra burimore, duke përfshirë dhe mbështetur të mësuarit gjatë gjithë jetës.*

<sup>5</sup> Miratuar me VKM nr. 276, datë 12.05.2021

*Politika orienton institucionet publike në masat që ato duhet të marrin për realizimin e aksesueshmërisë për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara në: (i) mjedise; (ii) transport; (iii) informacion e komunikim.*

*Sigurimi i një jete të pavarur për personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet: i. sigurimit të ofrimit të shërbimeve të integruara socioshëndetësore; ii. sigurimit të një jetese dinjitoze me anë të indeksimit të pagave, punësimit, rritjes së qasjes së tyre në transportin urban dhe ndërrurban, duke përmirësuar shërbimet dhe infrastrukturën e tij; iii. përfshirjes së tyre në sistemin arsimor publik.”.*

Ky dokument thekson faktin se, qeveria është e angazhuar të administrojë në mënyrë aktive çështjen e aftësisë së kufizuar në Shqipëri duke përditësuar gjithmonë e më shumë të drejtat e PAK në politikat e saj sektoriale. Për arritjen e këtij qëllimi është e nevojshëm edhe mbështetja më e fuqishme në eliminimin e të gjitha barrierave dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor publik.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se ekziston lidhja shkakësore ndërmjet trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë të konstatuar me shkakun e mbrojtur të aftësisë së kufizuar.

Në konkluzion për sa më sipër Komisioneri konstaton se Shkolla “Jani Nushi”, Lushnje, me veprimet dhe mosveprimet e saj, ka diskriminuar nxënësen I.K, për shkak të aftësisë së kufizuar, në të drejtën e saj për tu arsimuar, në kuptim të neneve 1, 3, 5 dhe 7 të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të LMD, përcaktohet se: “*Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre*”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të po këtij ligji, përcaktohet: “*Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës*”.

LMD, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit. LMD, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Subjekti ankues, gjatë seancës dëgjimore deklaroi se me mësuesen e re ndihmëse K.K ka bashkëpunim të mirë dhe ka firmosur plani PEI.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, masa e duhur në mënyrë që situata të ngjashme diskriminuese të parandalohen dhe të mos përsëriten, duhet që Shkolla e Mesme e Përgjithshme “Jani Nushi”, Lushnje, të marrë masa për garantimin e zbatimit të plotë të kuadrit ligjor dhe nënligjor për arsimimin gjithëpërfshirës të nxënësve me AK, përfshirë funksionimin e rregullt të komisioneve

përkatëse, përfshirjen efektive të prindit dhe sigurimin e mbështetjes arsimore sipas nevojave të fëmijëve

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e diskriminimit të nxënëses I.K, në të drejtën për arsim, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana Shkollës së Mesme të Përgjithshme “Jani Nushi”, Lushnje.
2. Në referim të pikës 1, Shkolla e Mesme e Përgjithshme “Jani Nushi”, Lushnje, në vijim, të marrë masa për garantimin e zbatimit të plotë të kuadrit ligjor dhe nënligjor për arsimimin gjithëpërfshirës të nxënësve me AK, përfshirë funksionimin e rregullt të komisioneve përkatëse, përfshirjen efektive të prindit dhe sigurimin e mbështetjes arsimore sipas nevojave të fëmijëve.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Genta TAFA (Bungo)**